



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 1476 Regj.
Nr. 1476/11 Prot.

Tiranë, më 17.01.2022

URDHËR

PËR HEQJE SEKUESTRO KONSERVATIVE

Drejtuar : QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Pranë Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor Privat "JUS" sh.p.k me kërkesë të palës kreditore është regjistruar çështja përmbarimore me numër Regj 1476 me palë:

Kreditor: SHOQËRIA "MVR" SH.P.K NIPT: L91609017K

Debitor: NEW OPPORTUNITIES NIPT: NUIS L71507037J

Objekti: Pagim faturash

Unë përmbaruesi gjyqësor Mario Hasanlliu pasi shqyrtova materialin e plotë të dosjes përmbarimore:

KONSTATOVA:

Në titullin ekzekutiv: **Vendimi nr. 17916 datë 16.12.2021 lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është përcaktuar detyrimi si palë debitore të paguaj kreditorit shumën prej 4,346,000 (katër milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë në fatura të pashlyera, si dhe kamatëvonesat ligjore në përputhje me legjislacionin në fuqi për: Faturën Tatimore me Nr. 93639610 datë 16.09.2020, në vlerën 1.992.000 lekë, Faturën Tatimore me Nr. 93639616 datë 20.09.2020, në vlerën 1.998.000 lekë, Faturën Tatimore me Nr. 93639604 datë 03.09.2020, në vlerën e mbetur 356.000 lekë Kamatëvonesat për faturat e pashlyera janë llogaritur deri në datën 21.12.2021, nga ekspert kontabel i certifikuar, në vlerën **440.186 lekë**. Tarifa përmbarimore për shumën totale të detyrimit është në masën **382.895 lekë**. Tarifa për akt- përllogaritjen e kamatvonesave është në masën **40.000 lekë****

Me shkresën tonë nr. 1476/7 prot datë 24.12.2021 është vendosur sekuestro mbi kuotat dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për shumën e detyrimit prej: **5.209.081 (pesë milion e dyqind e nëntë mijë e tetëdhjetë e një) lekë**, debitorit NEW OPPORTUNITIES NUIS L71507037J me



administrator Shkëlqim Llaçi, **BLU COLOR SRL ALBANIA NUIS: L72412038S** me administrator Shkëlqim Llaçi, në funksion të shlyerjes së këtij detyrimi.

Me kërkesën e datës 14.01.2022 të protokolluar nga ana jonë me nr. 3148 datë 17.01.2022 të perfaqësuesit të autorizuar nga Shoqëria MVR sh.p.k Kreshnik Ymeraj ku kërkohet heqja e masës së sekuestrove të vendosura pasi palët janë dakordësuar mbi mënyrën e likuidimit të detyrimit total.

Për këtë arsye :

Në bazë të nneve 593 e vijues të K.Pr.Civile e U. B. Sh "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në Banka"

URDHËROJ:

1 - Qendra Kombëtare e Biznesit të heqë sekuestron e vendosur me urdhërin Nr. 1476/7 Prot. datë 24.12.2021 mbi shoqërinë

- **NEW OPPORTUNITIES NUIS L71507037J** me administrator Shkëlqim Llaçi
- **BLU COLOR SRL ALBANIA NUIS: L72412038S** me administrator Shkëlqim Llaçi

2 - Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3 - Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

**PËRMBARUES GJYQËSOR
MARIO HASANLLIU**

